"Për ngritjen e një memoriali përkujtimor në Byshek, në vëndin ku sipas dokumentave, dëshmohen ngjarje me rëndësi historike për zonën e Shpatit".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.___.2022, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sektori i Trashëgimsë Kulturore dhe Turizmit në Bashkinë Elbasan ***"Për ngritjen e një memoriali përkujtimor në Byshek, në vëndin ku sipas dokumentave, dëshmohen ngjarje me rëndësi historike për zonën e Shpatit"***.

a. Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
b. VKM nr.416 datë 11.7.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Elbasan, të Qarkut Elbasan" (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e pëlqimit për ngritjen e një memoriali përkujtimor në Byshek, sipas Genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Arsimit Parashkollor ,Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve në Bashkinë Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Ciftja

Konceptoi:
Drejtoria e PTKTS: *E. Krraba* *A. Xhaja*
Drejtoria Juridike: *A. Hoxha*
Miratoi: V. Liço

780

24.06.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3004/1 Prot. Elbasan, më: 23.06.2022.

V E N D I M

Nr. 85 Datë: 23.06.2022.

"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kalimin në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes".

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajsthsme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.06.2022, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë *"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kalimin në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes";*

V E N D O S I:

1. Miratimin e fillimit të proçedurave për kalimin në pronësi të Bashkisë Elbasan në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim plotësimin e nevojave të saj në projektet zhvillimore, ekonomike e social-kulturore, të pasurive si më poshtë:

1. Poligon Qitje Rep. Usht. 8833, lagja "Konferenca Labinotit"
2. Ish Dega Ushtarake, lagja "Qemal Stafa"
3. Ish Rep. Usht. Nr. 9904 lagja "5Maj"
4. Ish Batalion AKA, Krastë Elbasan
5. Ish. Rep. Usht. Nr. 2410, lagja "28Nëntori"
6. Ish. Rep. Usht. Nr. 1498 SHLU, lagja "Shkumbin"
7. Grup Depo M (Ish.Rep.Usht Nr. 5012/18), Ullishtë, Elbasan
8. Rep. Usht. 5012/38, Shkumbin, Elbasan
9. Ish. Rep. Usht. Nr. 3081 (9856 dhe 9856/3), Fushë Mbret, Elbasan
10. Kompani IMKA Reparti Ushtarak Nr. 9856, Zaranikë, Fushë Mbret, Elbasan
11. Bateri AKA 100 mm Ish Reparti Ushtarak Nr. 9856/1, Krastë, Elbasan
12. Bateri AKA 57 mm Ish Reparti Ushtarak Nr. 9856/6, Rrapishtë, Elbasan
13. Ish Reparti Ushtarak Nr. 9161 Bateri AKA, Papër, Elbasan
14. Ish Shtabi Rep. Usht. 7040, Valas, Elbasan
15. Ish Reparti Ushtarak 7040 SHLU, Papër, Elbasan
16. Ish Reparti Ushtarak Nr. 9161 Bateri AKA, Papër, Kodër, Elbasan
17. Ish Reparti Ushtarak Nr. 3377, Balëz Sipër, Elbasan
18. Ish Reparti Ushtarak Nr. 3377 Bateri AKA, Karakullak, Elbasan
19. Ish Reparti Ushtarak Nr. 3377, Shijon, Elbasan
20. Ish Reparti Ushtarak Nr. 3377 (SHLU), Kombinati Metalurgjik, Elbasan

21. Ish Reparti Ushtarak Nr. 9900 (Ndërlidhja), Petresh, Elbasan
22. Bateri AKA 57 mm Ish Rep. Nr. 9856/4, Petresh, Elbasan
23. Kompania AKA 57 mm Rep. Usht. Nr. 9856/7, Bradashesh, Katundi i Ri, Elbasan
24. Shtabi i Rep. Usht. 8835 (BAO), Shirgjan, Mjekës Elbasn
25. Bateri AKA 100 mm Rep. 9856/2, Shirgjan, Kuqan, Elbasan
26. Ish Rep. Usht. Nr. 9900, Labinot-Fushë, Mengël, Elbasan
27. Ish Rep. Usht. Nr. 9907 Shkolla e Instruksionit, Griqan, Labinot-Fushë, Elbasan
28. Rep. Usht. Nr. 5012/13, Labinot-Fushë, Mengël, Elbasan
29. Ish Rep. Usht. Nr. 5012, Labinot-Fushë, Elbasan
30. Rep. Usht. Nr. 5012/16, Xibrakë, Elbasan
31. Grup Depo-AM (Ish.Rep.Usht. Nr. 5012/13), Gjergjan, Elbasan
32. Ish Posta Radioteknike P-10, Gjergjan, Elbasan
33. Furrë Buke e Rep. Usht. Nr. 4300, Mengël, Elbasan
34. Poligoni i Përgatitjes Taktike e Stërvitjes Rep.Usht.Nr.8835, Mjekës, Shirgjan, Elbasan
35. Ish Repart Ushtarak Nr. 3202, Balzë e Poshtme, Elbasan
36. Ish Batalion Fortifikimi, Krastë, Mengël, Elbasan
37. Tynele, Te Karejt, Papër, Elbasan
38. Tynele, Te Agajas, Papër, Elbasan
39. Tynele, Mali i Bardhë, Papër, Elbasan
40. Ish Rep. Usht. Nr. 716, lagja "5Maj", Elbasan

Gjithashtu pasuritë me nr.: 301/38; 301/39; 301/40; 301/41; 168/5; 168/57/2, ndodhur në Z.K. 8527, Elbasan.

2. Miratimin për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e dokumentacionit tekniko-ligjor sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Emergjencave Civile.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

KRYETARI

Hektor ÇIFTJA

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

Miratuar me 36 vota

Vota Pro 36

Vota kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 23/06/2022

781

24.06.2022

15

(8)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 3053/1 Prot. Elbasan, më 23.06.2022

Vendim
Nr 86 Datë 23/06/2022
Për miratimin e tarifave të ujit të pijshëm dhe largimit të ujrave të ndotura

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____/_____/2022, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga UK Elbasan sh.a., mbi gjendjen e shoqërisë dhe propozimin e saj për rishikimin e tarifave te ujit të pijshëm dhe largimit të mbeturinave, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 23, 54 te tij, ligjin 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura" i ndryshuar, ligjin 9901datë 14.04.2008 "Për tegtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, VKM 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimitme ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura"

Vendosi

1- Të miratojë tarifat e ujit të pijshëm dhe largimit te ujrave të ndotura, të propozuara nga shoqëria UK Elbasan sh.a. si më poshtë:

Përshkrimi	**Tarifa lekë**
Tarifa Mujore Fikse (Lekë/Lidhje/Muaj)	
Familjarë	**200**
Ente Private	**500**
Institucione buxhetore	**500**
Tarifa e furnizimit me ujë (Lekë/m³)	
Familjarë	**42**
Ente private	**160**
Institucione buxhetore	**140**
Tarifa e Kanalizimeve (Lekë/m³)	
Familjarë	**9**
Ente private	**30**
Institucione buxhetore	**25**

2- Ky vendim t'i përcillet Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largim it të ujrave të ndotura për miratimin e tarifave
3- Ngarkohet shoqëria UK Elbasan sh.a. me zbatimin e këtij vendimi

4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

D.P.SH.U.	*T. Sinani*
D.P.SH.I.P.P	*S. Mehmetaj*
D.P.P.A.A.B.F.	*L. Dervishi*
D. Juridike	*A. Hoxha*

Sek. K. Bashkiak

Klajd Gripshi

Kryetari

Hektor Ciftja

782 16 60

24.06.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 3054/1 **Prot.** **Elbasan, më** 23.06. **2022**

Vendim
Nr 87 **Datë** 23/06/**2022**
Pwr miratimin e planit tw biznesit tw shoqwrisw UK Elbasan.sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 23/06/2022, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga UK Elbasan sh.a., mbi gjendjen e shoqërisë dhe planin e saj të biznesit, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 23, 54 te tij, ligjin 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura" i ndryshuar, ligjin 9901datë 14.04.2008 "Për tegtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, VKM 63 datw 27.01.2016 "Pwr riorganizimin e operatorwve qw ofrojnw shwrbimin e furnizimitme ujw tw pijshwm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave tw ndotura"

Vendosi

1- Të miratojë planin e biznesit të shoqërisë UK Elbasan sh.a. bashkangjitur këtij vendimi
2- Ngarkohet shoqëria UK Elbasan sh.a. me zbatimin e këtij vendimi
3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

D.P.SH.U. *T. Sinani*
D.P.SH.I.P.P *S. Mehmetaj*
D.P.P.A.A.B.F. *L. Dervishi*
D. Juridike *A. Hoxha*

Sek. K. Bashkiak

Klajd Gripshi

Kryetari

Hektor Ciftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb:ëëë.elbasani.gov.al*

16

BASHKIA
ELBASAN

6

SHOQËRIA UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN

PLANI I BIZNESIT
2023-2027



Përgatitur nga:
Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan
Eksperte: Lulzime Dama
Rovena Halili

FJALA

Plani i Biznesit i Shoqërisë Ujësjellës-kanalizime Elbasan 2023-2027 është hartuar nga grupi i punës i shoqërise Ujësjellës-Kanalizime me eksperte Lulzime Dama dhe Rovena Halili.

Gjatë procesit të hartimit të Planit të Biznesit u bë një shqyrtim tërësor i kushteve aktuale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime. U realizua edhe një analizë e hollësishme e mundësive, forcave dinamike dhe sfidave me të cilat përballet shoqëria te cilat ndikojnë në sigurimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në zonën e mbulimit me shërbim.

Për zbatimin e këtij Plani Biznesi do të nevojitet angazhimi i çdo punonjësi të shoqërisë dhe përkushtimi i plotë i Këshillit të Administrimit dhe sigurisht edhe mbështetja e Bashkisë Elbasan, pronarit të ligjshëm të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan. U mor me seriozitetin më të madh mendimi dhe sugjerimi i çdo anëtari të stafit në procesin e përgatitjes së këtij plani biznesi dhe që do të vlejnë shumë edhe gjatë zbatimit të tij.

Edhe pse dalin disa vështirësi financiare që duhet të trajtohen në vitet e para të planit, ajo që është e qartë se Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan mund dhe do të bëhet një shoqëri ujësjellës-kanalizime financiarisht e qëndrueshme që do të mund të ofrojë shërbim cilësor për qytetarët e Bashkisë Elbasan.

Z. Leli KAJA
Administrator
Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan

8

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PREZANTIM I PËRGJITHSHËM I SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME 5

2. DEKLARATA E VIZIONIT DHE MISIONIT 8

3. KONCEPTIMI I PLANIT TË BIZNESIT NGA GRUPI I MENAXHERËVE TË SHOQËRISË 9

4. ANALIZA DHE PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR UJË 11

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE NË PLANIN E BIZNESIT 15

6. PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE 17

7. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PLANI I PERSONELIT 18

8. BUXHETI DHE PARASHIKIMI 5-VJEÇAR PËR OPEREMIN DHE MIRËMBAJTJEN 23

9. NEVOJA PËR TË ARDHURA DHE ANALIZA E TARIFËS 26

SHTOJCA A 28

PROGRAMET E PËRMIRËSIMIT TË PERFORMANCËS 28

I. VEPRIMI SPECIFIK 29

II. OBJEKTIVI STRATEGJIK I TRAJTUAR 29

III. PËRSHKRIMI I VEPRIMEVE 29

IV. TREGUES TË MATSHËM NË PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS 30

I. VEPRIM SPECIFIK 30

II. OBJEKTIVI STRATEGJIK I TRAJTUAR 30

III. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT 30

IV. TREGUES TË MATSHËM NË PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS 31

3

I. VEPRIM SPECIFIK 32

II. OBJEKTIVI STRATEGJIK I TRAJTUAR 32

III. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT 32

IV. TREGUES TË MATSHËM NË PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS 32

SHOQËRIA UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN 33

I. VEPRIMI SPECIFIK 33

II. OBJEKTIVI STRATEGJIK I TRAJTUAR 33

III. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT 33

IV. TREGUES TË MATSHËM NË PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS 33

I. VEPRIMI SPECIFIK 34

II. OBJEKTIVI STRATEGJIK I TRAJTUAR 34

III. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT 34

I. VEPRIMI SPECIFIK 35

II. OBJEKTIVI STRATEGJIK I TRAJTUAR 35

III. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT 35

1.1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan siguron shërbimin me pakicë ujësjellës-kanalizime për konsumatorët e saj të regjistruar brenda kufijve administrativë të Bashkisë Elbasan.

Fig. 1-1 tregon kufijte administrative te Bashkise Elbasan në lidhje me ofrimin e shërbimit ujësjellës-kanalizime.

Figura 1-1

Zona e shërbimit e UK Elbasan sha



Për të qartësuar llogaridhënien mbi performancën e shoqërisë, reformat e sektorit të ujit janë shumë specifike për sa i përket strukturës së drejtuesve të lartë operacionalë të shoqërisë. Në këtë aspekt, ka vetëm një Administrator, i emëruar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan. Funksionet e shoqërisë kontrollohen nga dy Zëvendës Administratorë dhe Drejtorët e Drejtorive; Drejtor Teknik, Drejtor Tregtar, Drejtor i Burimeve Njerezore, Drejtor Auditi i Brendshem, Drejtor Sherbime te Pergjithshme, Drejtor Juridik. Çështjet që lidhen me ristrukturimin organizativ dhe me nivelet e stafit për shoqërinë UK Elbasan Sha do të trajtohen me më shumë hollësi më poshtë në këtë Plan Biznesi.

Problemet e hasura nga Shoqëria UK Elbasan janë sa unike aq edhe të ngjashme me problemet me të cilat jane ballafaquar dhe shoqëritë e tjera të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në të gjithë Shqipërinë. Këto probleme kanë të bëjnë me unifikimin e sistemit të shërbimit në të gjithë zonën e shërbimit, me nivelin e lartë të "ujit të pafaturuar"; me investimet në sistemin e kanalizimeve në zonat rurale; me vazhdimësinë e ulët të shërbimit, duke rezultuar në periudha ndërprerjeje të furnizimit gjatë ditës në një pjesë të konsiderueshme të zonës së shërbimit; me nivelin jo te kenaqshem të arkëtimit të të ardhurave përfshirë këtu edhe shumat e prapambetura; paaftësia për të mbuluar kostot nëpërmjet tarifave.

1.2 Statistika dhe treguesit e fundit të performancës

Tabela 1-1 ka përfshirë të dhëna dhe tregues të performancës për UK Elbasan. Ky Plan Biznesi konsideron vitin 2021 si vit bazë, që do të shërbejë si bazë për supozimet dhe parashikimet në Planin 5-vjeçar të Biznesit.

Tabela 1-1
Të dhënat dhe treguesit e performancës për vitin bazë - 2021

Të dhënat dhe treguesit e performancës	UK Elbasan
Popullsia në zonën e shërbimit	218.780
Mbulimi me Shërbim Ujësjellës i Popullsisë	71.55%
Mbulimi me shërbim kanalizimesh	56.95%
Numri i Lidhjeve të Regjistruara të Ujit:	
Familjarë	36151
Biznese private	3,654
Institucione buxhetore	262
Lidhje me matës (% e lidhjeve totale)	75%
Vëllimi vjetor i ujit të faturuar (m^3)	4.571.469
Vëllimi vjetor i ujit të prodhuar (m^3)	17.498.000
Përqindja e ujit pa të ardhura	73.87%
Norma aktuale e arkëtimeve (vlera e arkëtimeve të këtij viti ndaj vlerës së faturimeve)	76.6%
Norma e arkëtimeve të faturave të prapambetura (vlera e arkëtimeve të prapambetura në vitin aktual ndaj totalit të faturave të prapambetura)	20%
Mbulimi i kostos direkte të operimit me të ardhurat	76.7%
Mbulimi i kostos direkte të operimit me arkëtimet korente*	65.8%
Mbulimi i kostos totale të operimit me të ardhurat	59.2%
Mbulimi i kostos totale të operimit me arkëtimet korente*	33.4%
Staf për 1,000 lidhje (ujësjellës + kanalizime)	5.3

Struktura aktuale e tarifës së UK Elbasan përbëhet nga kombinimi i tarifës fikse (lekë për lidhje/muaj) dhe tarifës variabël (lekë për metër kub ujë të konsumuar) bazuar në tarifat e miratuara nga Enti Rregullator i Ujit. Tabela 1-2 jep një përmbledhje të të gjitha tarifave të aplikuara në vitin 2021.

Tabela 1-2

12

Struktura e tarifës për shërbimin ujësjellës-kanalizime

Kategoria	UK Elbasan
Familjarë	180
Institucione buxhetore	500
Biznese private	500

Kategoria	UK Elbasan
Familjarë	38, 35, 23
Institucione buxhetore	115, 130
Biznese private	130

Kategoria Kanalizime	UK Elbasan
Familjarë	8.3
Institucione buxhetore	25
Biznese private	30

7

2. DEKLARATA E VIZIONIT DHE MISIONIT

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan ka përcaktuar deklaratën e saj të Vizionit dhe Misionit si më poshtë:

VIZIONI

Të përmirësojmë vazhdimisht shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për klientët tanë për të fituar besimin, respektin dhe mbështetjen e tyre.

MISIONI

- Të ofrojë shërbim të qëndrueshëm ujësjellësi në sasi të mjaftueshme dhe me cilësinë e duhur, në përputhje me standardet në fuqi dhe me çmim të arsyeshëm, për të gjithë konsumatorët.
- Të krijojë një mjedis pune stimulues, përmbushës dhe shpërblyes për punonjësit e shoqërisë nëpërmjet ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve dhe programeve të zhvillimit të stafit.

14

3. KONCEPTIMI I PLANIT TË BIZNESIT NGA GRUPI I MENAXHERËVE TË SHOQËRISË

3.1 Hyrje

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan (UK Elbasan) ka kënaqësinë të paraqesë këtë Plan Biznesi dhe Programin e Përmirësimit të Performancës (2023-2027) si një hap i parë i ndryshimit pozitiv në lidhje me administrimin e shërbimeve ujësjellës-kanalizime për të siguruar funksionimin e shërbimeve bazë financiarisht të vetë-qëndrueshme për qytetarët në Bashkinë Elbasan.

Hartimi i këtij Plani Biznesi nuk ka qenë puna e një individi të vetëm, por përpjekje e përbashkët e drejtuesve të lartë të UK Elbasan.

Plani i Biznesit bëri të mundur që UK Elbasan të identifikonte me objektivitet dhe të trajtonte sfidat madhore me të cilat përballet për shërbimin që duhet t'i sigurojë zonës së shërbimit.

3.2 Përmbledhje e gjendjes aktuale të UK Elbasan

Drejtuesit e lartë të UK Elbasan në konsensus me Bashkinë Elbasan, e dinë tashmë që UK Elbasan është një veprimtari tregtare jo efiçiente, e cila mund të bëhet mjaft shpejt një barrë e madhe financiare për buxhetin e Bashkisë Elbasan, pronare e vetme e kësaj shoqërie. Kohët e fundit shoqëria ka pasur humbje të mëdha financiare vjetore operative, të tilla që nuk mund të mbulojë shpenzimet e veta operative.

Nga analiza e plotë e të dhënave e UK Elbasan, pavaresisht perpjekjeve per rritje te performancës financiare, akoma ka nivel të ulët arkëtimi të faturave korente, fatura të prapambetura dhe sasi të madhe të ujit të pafaturuar.

Për shkak të ndikimit të përgjithshëm negativ të këtyre mangësive, UK Elbasan nuk gjeneron mjete monetare të mjaftueshme për të financuar rezervat e veta kapitale, përfshirë këtu rinovimet, riparimet, zëvendësimet dhe investimet e reja kapitale. Si përfundim, kjo situatë, vë në pikëpyetje shërbimin e qëndrueshëm të kësaj shoqërie.

3.3 Fokusi për çështjet prioritare të përmirësimit të performancës

Duke pasur parasysh kushtet aktuale të UK Elbasan të përmbledhura më sipër, drejtuesit e lartë të shoqërisë kanë përcaktuar një sërë planesh veprimi të nevojshme dhe agresive të përmirësimit të performancës për të rregulluar situatën dhe për ta vënë UK Elbasan në rrugën e përmirësimit në çdo aspekt të operacioneve të saj. Planet e veprimit të përmirësimit të performancës janë detajuar në Planin e Biznesit dhe mbështeten nga një model shumë i përparuar matematikor biznesi për të siguruar që çdo çështje mbi performancën të përcaktohet, të matet e monitorohet me objektivitet.

Fushat e fokusit të këtyre planeve të veprimit për përmirësimin e performancës përmblidhen si më poshtë:

- **Përmirësimi i procedurave financiare**

  Nuk mjafton vetëm të bësh llogari kur administron një shërbim intensiv kapital si ujësjellës-kanalizime që supozohet të jetë financiarisht i vetë-qëndrueshëm. Analizat e shëndosha financiare dhe praktikat e parashikimeve financiare duhet të aplikohen vazhdimisht dhe të kuptohen nga të gjithë drejtuesit e lartë të UK Elbasan. Nuk mund të bëhen shpenzime nëse nuk janë përfshirë më parë në një buxhet të balancuar. Nuk mund të merren as kredi e hua deri sa burimi i të ardhurave që e mbulojnë atë të jetë evidentuar dhe projektuar qartësisht për jetëgjatësinë e huas apo kredisë. Drejtuesit e shoqërisë janë të angazhuar ndaj këtyre parimeve për administrimin financiar të saj dhe i vënë ato në praktikë edhe gjate periudhes se këtij plani biznesi.

9

- **Rritja e normës së arkëtimit të faturave**

  Rritja e normës së arkëtimit të faturave duhet trajtuar me vëmendje të veçantë dhe të menjëhershme nëse duam të arrijmë qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe nëse është e pamundur të arkëtohen faturat, atëherë duhet të ndërpritet shërbimi për klientin që nuk paguan. Shërbimi ujësjellës-kanalizime është përgjegjësi e përbashkët mes shoqërisë dhe klientit. Duhet të ofrohet shërbim cilësor si dhe faturat të paguhen rregullisht dhe në kohë.

  Në situatën aktuale, UK Elbasan ka dyfishuar përpjekjet jo vetëm për vjeljen e pagesave në kohë por të mbledhë edhe ato të prapambeturat.

- **Reduktimi i ujit pa të ardhura**

  Uji që prodhohet por nuk shitet (uji pa të ardhura), por që thjesht "zhduket" në sistem, duhet të pakësohet në mënyrë drastike në UK Elbasan. Uji pa të ardhura është thjesht i barabartë me kostot e energjisë elektrike dhe kimikatet e trajtimit, kosto që në këtë rast humbasin. Plani i Biznesit parashikon që UK Elbasan do të reduktojë ujin pa të ardhura nga 73.87% në 57.16% gjatë viteve te ardhshme. Ky reduktim do të ndikojë në uljen e faturës së energjisë elektrike si një nga zërat kryesor të kostove. Megjithatë, menaxhimi është i vetëdijshëm që 57.16% nuk është një nivel i pranueshëm kështu që do të vazhdojë të punojë për ta ulur ujin pa të ardhura përtej periudhës së planit të biznesit.

3.4 Monitorimi dhe raportimi i performancës

Drejtuesit e lartë të UK Elbasan janë të angazhuar për të administruar dhe monitoruar performancën e shoqërisë sipas strukturës dhe në mënyrë periodike duke përdorur raporte mujore, tremujore dhe vjetore të analizës së punës për të bërë krahasimin me objektivat e synuar në planin e biznesit. Këto analiza pune do t'i bëhen të ditura personave përgjegjës në UK Elbasan dhe Bashkisë Elbasan.

Drejtuesit e lartë janë të angazhuar edhe për kryerjen e përditësimit vjetor të këtij Plani Biznesi, në mënyrë që çdo vit të shtohet një vit pasardhës për të pasur një panoramë disa vjeçare në lidhje me drejtimin e biznesit.

16

4. ANALIZA DHE PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR UJË

4.1 Përshkrim

Menaxhimi i kërkesës për ujë nga UK Elbasan ka qenë gjithmonë një çështje prioritare, pasi sistemi i furnizimit me ujë është kryesisht me ngritje mekanike. Prandaj, shumica e ujit në sistem vjen nga puset deri në depot e magazinimit për të furnizuar zonat urbane dhe ato rurale. Kjo nevojë për t'u mbështetur në furnizim me ujë me ngritje mekanike, e bën energjinë një kosto të konsiderueshme për kompaninë.

Analiza e hollësishme e kërkesës aktuale dhe të parashikuar të ujit dhe reduktimi i parashikuar i UPA-së është paraqitur në këtë seksion të Planit të Biznesit.

4.2 Metodologjia për përcaktimin e Kërkesës për Ujë

Si pjese e ketij Plani Biznesi eshte ndertuar nje Flete Llogaritjeje (ne Excel) per te mbeshtetur llogaritjet qe duhen per te percaktuar kerkesen per uje, qe i bashkengjitet Planit te Biznesit.

Metodologjia e përdorur në këtë Plan Biznesi për parashikimin e kërkesës për ujë mbështetet në përcaktimin e një kërkese për frymë për popullsinë e shërbyer. Kjo popullsi e shërbyer analizohet e lidhur ngushtë me të dhënat në dispozicion për vëllimin e shitjeve (m^3) të ndara në pjesën e matur (bazuar në leximet e ujëmatësave) dhe në pjesën e pamatur (bazuar në normat e faturimit). Norma e kërkesës për frymë, siç zbatohet në këtë metodologji, llogaritet si nevoja e përgjithshme për konsum e të gjithë përdoruesve të ujit në zonën e shërbimit, pjestuar me numrin e personave të furnizuar në fakt.

4.2.1 Popullsia në Zonën e Shërbimit dhe Popullsia e Shërbyer

Hapi i parë në parashikimin e kërkesës për ujë është të përcaktohet popullsia "totale" dhe ajo e "sherbyer" brënda zonës së shërbimit të Shoqërisë UK Elbasan, si dhe "kërkesa për ujë për frymë në ditë", duke qënë se këto janë dy variablet e vetëm që do të përdoren për zbatimin e kesaj metodologjie.

Qasja e ndërmarrë në përpjekje për të vlerësuar me saktësi "popullatën e shërbyer" ishte shqyrtimi i të dhënave aktuale të klientëve të kompanisë.

Shoqëria UK Elbasan ka 36.151 konsumatorë familjarë të regjistruar (aktivë dhe joaktivë), nga të cilët 27.608 përfaqësojnë lidhje familjare aktive dhe 8.543 përfaqësojnë lidhje familjare jo aktive.

Aktualisht kemi mbulim shërbimi prej 71.6% për Popullsinë e Zonës së Shërbimit në vitin bazë 2021, siç tregohet në Tabelën 4-3.

Tabela 4-3
Popullsia në Zonën e Shërbimit dhe Popullsia e Shërbyer – Viti Bazë 2021

Përshkrimi	UK Elbasan
Popullsia në Zonën e Shërbimit	218,780
Popullsia e Shërbyer	156.546
Popullsia e pa Shërbyer	63.653
% e Popullsise qe ka Sherbime Ujesjellesi	71.6%

11

Një nga objektivat strategjike të shoqërisë është që të arrijë 81.75% të mbulimit të ujit në vitin 2027 brenda zonës së shërbimit.

Duke marrë parasysh këtë Qëllim Strategjik, drejtuesit e shoqërisë UK Elbasan kanë supozuar se lidhjet e reja të ujit të nevojshme në vitet 2023 – 2027 do të rezultojnë kryesisht nga lidhje te reja si pasoje e ndertimeve shumekateshe dhe si rezultat i zgjerimit të sistemit të furnizimit me ujë të UK Elbasan ne zonat rurale. Përqindjet për këtë qëllim për secilën prej viteve të Planit të Biznesit shërbejnë për të llogaritur numrin e lidhjeve të reja shtëpiake për çdo vit.

Drejtuesit e shoqërisë kanë qenë qëllimisht konservativ në vlerësimet e tyre të popullsisë, pasi kjo vlerë, së bashku me vlerën e supozuar të shitjes së ujit për frymë, shpërndan shitjet e vlerësuara të ujit, të cilat pastaj ndikojnë drejtpërdrejt në të ardhurat e parashikuara të kompanisë në parashikimin e tij të buxhetit.

Një tjetër analizë e rëndësishme që do të ndikojë në vendimet e investimeve është numri i lidhjeve të matura sipas kategorive të konsumatorëve. Futja e këtyre të dhënave në modelin e punës lejon një llogaritje të përqindjes së lidhjeve të matura siç tregohet në Tabelën 4-5.

Tabela 4-5
Numri i Lidhjeve te Matura Sipas Kategorive te Klienteve
Viti Bazë 2021

Kategoria e Klientit	Numri Total i Lidhjeve	Numri i Lidhjeve me Ujëmates	% e Lidhjeve me Ujëmates
Familjare	36.152	26.642	73.7%
Ente Private	3.654	3.398	93%
Institucione Buxhetore	262	247	94.3%

Shoqëria është e angazhuar për të bërë përpjekje të mëdha për të rritur përqindjen e lidhjeve me matës gjatë periudhës së këtij Plan Biznesi, në mënyrë që të rrisë lidhjet e matura në zonën e shërbimit të Elbasanit nga 73.7% në 2021 në 88.8% për konsumatorët familjarë deri në fund të vitit 2027, dhe 100% të matura për subjektet private dhe kategoritë e institucioneve buxhetore deri në fund të vitit 2027.

Zbatimi i një sistemi matës të efektshëm dhe gjithëpërfshirës në të gjithë zonën e shërbimit të UK Elbasan, që përfshin furnizimin dhe instalimin e matësve të konsumatorëve për të gjitha lidhjet në zonën e shërbimit, do të përmirësojë në masë të madhe besueshmërinë e bazës së të dhënave aktuale të konsumatorëve.

Me këto objektiva të deklaruara, modeli i Planit të Biznesit llogarit numrin e matësve që duhet të instalohen, për çdo vit, sipas kategorive të konsumatorëve. Kjo përllogaritje aktualisht përcakton nevojën për të blerë dhe instaluar gjithsej 4.058 ujëmatës të konsumatorëve brenda periudhës të Planit të Biznesit për zonën ekzistuese duke filluar nga fillimi i vitit 2023. Instalimi i ujëmatësve për entet private dhe institucionet buxhetore, siç kërkohet nga ligji, duhet të paguhet nga konsumatorët përkatës në këto kategori.

Tabela 4-6 paraqet objektivat vjetore për ujëmatësit familjarë që do të instalohen në mënyrë që të arrijnë objektivat e lidhjeve të matura të kategorisë së konsumatorëve familjarë me 88.8%, të cilat përfshijnë si kontratat e reja gjatë periudhës së planifikimit ashtu edhe

konsumatorët ekzistues jo të matur në zonën e Shërbimit të UK Elbasan.

Tabela 4-6
Lidhjet e reja të parashikuara në 2023-2027

Ujëmatësit Familjarë	2023	2024	2025	2026	2027
Numri i lidhjeve familjare të matura	32,161	33,036	33,796	34,694	35,430
Numri i lidhjeve familjare të pa matura	5,491	5,216	4,956	4,708	4,472
% e lidhjeve familjare me matje	85.4%	86.4%	87.2%	88.1%	88.8%
Lidhje familjare të reja të matura në vit	789	875	761	898	735

4.2.2 Kërkesa për Ujë për Frymë Aktuale dhe e Parashikuar

Shumica e metodave të parashikimit të kërkesës për ujë në zona urbane përdorin një vlerësim statistikor për kapita (ose për klient) të normave të përdorimit të ujit bazuar në të dhënat aktuale të matur të konsumit. Në rastin e UK Elbasan, rreth 73.7% e konsumatorëve familjar faturohen në një bazë volumetrike të matur, e cila korrespondon me një shitje mesatare familjare prej 81 litra / frymë në ditë.

Këto kërkesa të llogaritura për kapita në ditë paraqesin kërkesa relativisht të ulëta, në krahasim me sistemet e ngjashme në rajon dhe, në fakt, në sisteme të ngjashme në Shqipëri (p.sh. UK Korçë, e cila ka lidhje familjare të matura në nivelin 100% ka një kërkesë prej 90 litra / frymë / ditë). Kjo mund të jetë për shkak të disa faktorëve të përmendur më poshtë:

- Problematikat e Ujëmatësve.
- Lidhje sekondare të paligjshme.
- Lexim i keq i matësve.

Shoqëria ekzistuese e UK Elbasanit faturon të gjitha lidhjet aktive familjare të pamatura me aforfe bazuar në numrin banorëve për familjeve, miratuar nga Enti Rregullator i Ujit dhe është e barabartë me 4.5 m3 / muaj për banor.

Duke pasur parasysh shitjet e vëllimit të ujit, nga secila kategori e konsumatorëve dhe duke përdorur popullsinë e shërbyer dhe popullsinë e përgjithshme në zonën e shërbimit, Modeli i Planit të Biznesit llogarit shitjet aktuale në litra / frymë / ditë për kategorinë familjare të matur e të pamatur, siç tregohet në Tabelën 4 -7.

Tabela 4-7
Shitjet Aktuale të Ujit (litër/frymë/ditë)

Katergoritë e Konsumatorëve	Shitjet Aktuale të ujit për UK Elbasan Ekzistues
Familjar të matur dhe të pamatur	84.0
Familjarë të matur	81.0
Familjarë të pamatur	150.0

Në trajtimin e çështjes së kërkesës për ujë, është gjithashtu e përshtatshme të merren parasysh normat e kërkesës për frymë që pasqyrojnë përdorimin e ujit të matur në zona të

ngjashme me ato të Shqipërisë. Tabela 4-8 përfaqëson shkallët e kërkesës për frymë, sipas llojit të konsumatorit, që mund të gjenden në vende të ngjashme me Shqipërinë.

Tabela 4-8
Norma të Aplikueshme në Rajon

Kategoria e Konsumatorëve	Norma të Aplikueshme në Shqipëri (l/c/d)
Familjarë	80-110
Ente Private	15-25
Institucione Buxhetorë	5-10
Total1	**115-175**

Gjatë shqyrtimit të Parashikimit të Shitjes së Ujit, drejtuesit e shoqërisë vendosën për normat e shitjes për frymë (litra / frymë /në ditë) për secilën kategori të konsumatorëve (familjarë, ente private dhe institucione buxhetore) për secilin prej vit të Planit të Biznesit, për të pasqyruar një vlerësim të shitjeve të ujit për frymë në ditë sipas kategorive të konsumatorëve siç tregohet në Tabelën 4-9, të cilat bazohen në normat, referuar **Tabelës 4-8.**

Gjatë përcaktimit të normave të parashikuara të kërkesës për ujë për periudhën 2023-2027, drejtuesit e shoqërisë morën parasysh që lidhjet e matura familjare do të rriten në 88.8% deri në fund të vitit 2027.

Tabela 4-9
Shitjet e Projektuara të Ujit (liters/frymë/ditë)

Kategoria e Konsumatorëve	2023	2024	2025	2026	2027
Familjar të matur dhe të pamatur	98.8	99.0	100.3	99.8	99.4
Familjarë të matur	90.0	91.0	93.0	93.0	93.0
Familjarë të pamatur	150.0	150.0	150.0	150.0	150.0

Bazuar në vlerat e shitjes në Tabelën 4-9 për secilën kategori të konsumatorëve, Modeli llogariti parashikimin total vjetor të shitjeve të ujit (për lidhjet e matura dhe të pa matura) për secilën prej viteve të Planit të Biznesit, për secilën nga kategoritë e konsumatorëve. Tabela 4-10 paraqet shitjet totale volumetrike të parashikuara të ujit për secilën kategori konsumatorësh. Ky është vëllimi i ujit që UK Elbasan pret të shesë, i cili do të përdoret në llogaritjet e të ardhurave.

Tabela 4-10
Shitjet e Ujit për secilën Kategori Konsumatorësh
(m^3/vit)

Shitja e Ujit	2023	2024	2025	2026	2027
Familjarë	5,070,654	5,185,432	5,338,253	5,415,800	5,476,958
Ente Private	250,888	251,139	251,390	251,641	251,893
Institucione Buxhetorë	312,118	312,568	313,168	313,369	313,839

Shitjet Totale të Ujit	**5,633,661**	**5,749,138**	**5,902,811**	**5,980,810**	**6,042,690**

4.2.3 Kërkesa Totale për Ujë dhe Uji pa të Ardhura

Sasia e ujit të prodhuar nga shoqëria UK Elbasan, e cila është dërguar në sistemin e shpërndarjes në Vitin Bazë, është mesatarisht 47940 m³ / ditë. Shoqëria për vitin bazë 2021, bleu 80 m3 / ditë, sasi të ujit të pijshëm me shumicë, nga sistemi i ujësjellësit të UK Cërrik.

Duke pasur parasysh volumin e ujit të dërguar në sistem në vitin bazë dhe shitjet e ujit me pakicë për të gjitha lidhjet, mund të përcaktohet se vlera aktuale e Ujit pa të Ardhurave ose Uji i Humbur është 73.87% e sasisë së ujit të prodhuar. Qëllimi strategjik i Shoqërisë është zvogëlimi i ujit pa ardhura nga 73.87% në vitin bazë 2021 deri në 57.16% në fund të vitit 2027.

Tabela 4-11 tregon ndikimin e reduktimit në përqindje të ujit pa të ardhura, duke filluar nga Viti Bazë dhe gjatë periudhës së Planit të Biznesit, për të gjithë zonën e shërbimit të furnizimit me ujë.

Tabela 4-11
Parashikimi i Uljes së Ujit të Prodhuar dhe % së Ujit pa të Ardhura (m³/ditë)

Përshkrimi	**2021**	**2023**	**2024**	**2025**	**2026**	**2027**
Shitjet e Ujit me Pakicë	12,525	15,435	15,751	16,172	16,386	16,555
Shitjet e Ujit me Shumicë	-	0	0	0		0
Shitjet Totale të Ujit	**12,525**	**15,435**	**15,751**	**16,172**	**16,386**	**16,555**
Uji I Prodhuar	47,012	38,000	36,200	35,800	33,000	32,800
Uji pa të Ardhura	**47,940**	**34,370**	**30,942**	**24,722**	**19,710**	**18,441**
Uji pa të Ardhura %	**73.87%**	**74.42%**	**66.94%**	**58.15%**	**57.59%**	**57.16%**

4.3 Lidhjet e Rregjistruara të Kanalizimeve

Aktualisht shoqëria ekzistuese UK Elbasan shërben 56.95% të popullsisë me shërbime të kanalizimeve, që përfaqëson 32.361 lidhje të tilla.

Drejtuesit e shoqërisë kanë vendosur të mos ndërmarrin veprime drastike për të rritur mbulimin e shërbimit të kanalizimeve brenda zonës së shërbimit gjatë periudhës së planit të biznesit. Gjatë periudhës së planit të biznesit modeli i punës ka llogaritur një sasi mesatare të lidhjeve të reja të kanalizimeve (544 lidhje) të nevojshme për çdo vit, që është rezultat i drejtpërdrejtë i rritjes së lidhjeve të shërbimit të ujit, kryesisht për shkak të legalizimit të atyre ekzistuese të cilat ishin të paligjshme.

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE NË PLANIN E BIZNESIT

Në hartimin e këtij Plan Biznesi për vitet 2023-2027, UK Elbasan, pas një analizimi të hollësishëm të performancës, ka përcaktuar objektivat e veta strategjike për periudhën e këtij Plani Biznesi. Këto Objektiva Strategjike orientojnë çështjet prioritare të evidentuar nga drejtuesit e lartë që përcaktojnë planet prioritare të veprimit për shoqërinë si dhe bazat për ndarjen e burimeve dhe investimeve të nevojshme kapitale.

21

Në identifikimin dhe përzgjedhjen e këtyre Objektivave Strategjike, ekipi drejtues i Shoqërisë ka qenë i kujdesshëm për t'u siguruar që Objektivat Strategjike të përcaktuara të jenë specifike, të matshme, të arritshme në afatet kohore dhe në termat e vlerësimit të realizimit së tyre.

Këto Objektiva Strategjike janë:

- Reduktimi i ujit pa të ardhura nga 73.8% në 2021 në 57.16% deri në vitin 2027, matur si vëllimi total i ujit të prodhuar dhe dërguar në sistem, minus vëllimin e ujit të shitur, bazuar në faturat e lëshuara, pjesëtuar me vëllimin total të ujit të prodhuar dhe dërguar në sistem, e shprehur si përqindje. Objektivat e ndërmjetëm për reduktimin e ujit pa të ardhura tregohen më poshtë:

Viti	UK Elbasan
2023	74.42%
2024	66.94%
2025	58.15%
2026	57.59%
2027	57.16%

- Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë për të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan, nga 71.55% në 2021 në 81.75% në 2027, duke u fokusuar në rritjen e mbulimit me shërbim ujësjellësi për zonat ekzistuese.

- Rritja e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve për të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan, nga 56.95% në 2021 në 60.79% në 2027, duke u fokusuar në rritjen e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve për zonën ekzistuese.

- Zbatimi i një sistemi që do të masë në mënyrë të saktë konsumin e të gjithë konsumatorëve duke synuar të arrijë nga 75% në 2021 në 90% nivelin e matjes në vitin 2027.

- Rritja e nivelit të arkëtimit të faturave matur si përqindje e vlerës totale të faturave të lëshuara dhe arkëtuar në një vit të dhënë nga niveli 76.6% në 2021 në 89.0% në 2027. Shoqëria do të fokusohet edhe në përmirësimin e normës së arkëtimit të faturave të prapambetura duke shkuar nga niveli i 24.3% në 2021 në 35% në 2027.

- Arritja e mbulimit të mbi 100% të kostos së shpenzimeve operacionale dhe të mirëmbajtjes, në bazë të arkëtimeve, deri në vitin 2027 dhe vazhdimi i përmirësimit të performancës financiare të shoqërisë në mënyrë të atillë që të nisë të kontribuojë në fondet rezervë të kapitalit nga rezultati financiar vjetor pozitiv.

16

22

6. PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE

Nevojat për investime kapitale, në sistemet urbane dhe rurale të ujësjellësit të menaxhuara nga UK Elbasan, janë vlerësuar bazuar në kushtet aktuale të këtyre sistemeve dhe aktiveve kapitale.

Në një masë të madhe, shumica e investimeve të realizuara gjatë viteve të fundit janë bërë kryesisht në zëvendësimin e pompave dhe në rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit.

6.1 Investimet kapitale të nevojshme gjatë periudhës së Planit të Biznesit

Në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe performancës së matshëm të shërbimeve, për sa më sipër do të nevojiten investime kapitale për përmbushjen e objektivave strategjike të mëposhtme, në mënyrë të veçantë:

- Reduktimi i ujit pa të ardhura dhe rritja e nivelit të matjes
- Rritja e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve
- Përmiresimi I performancës së shoqerise

6.1.1 Investimet e reja kapitale

Siç u përmend më sipër, investimet kapitale të propozuara në Planin e Biznesit për periudhën e planifikimit fokusohen mbi përmirësimin e performancës që do të kontribuojë në përmirësimin e shërbimit në zonat rurale te UK Elbasan sha.

Këto investime kapitale, që arrijnë në 67.8 milionë Lekë që do të financohen nga fondet e shoqërisë dhe 13.8 milionë euro nga financues të tjerë.

a. Reduktimi i ujit pa të ardhura dhe rritja e nivelit të matjes

Për të mbështetur përpjekjet për të reduktuar ujin pa të ardhura, në të gjithë zonën e shërbimit, UK Elbasan do të kryejë rehabilitimin e pjesshëm të rrjetit të furnizimit me ujë. Vlerësohet se ky investim do të kushtojë rreth 14.2 milionë Lekë dhe do të financohet nga fondet e shoqërisë.

Duke punuar drejt reduktimit të ujit pa të ardhura, UK Elbasan ka në plan të bëjë investime të mëdha për matjen e prodhimit, depozitave si dhe në zonat urbane. Gjithashtu shoqëria do të bëjë investime në rikonstruksionin e ndërtesave të STP.

b. Zgjerim rrjeti për të rritur mbulimin me shërbimin e kanalizimeve

Për të punuar në drejtim të rritjes dhe përmirësimit të mbulimit me shërbim kanalizimi në të gjithë zonën e saj të shërbimit, UK Elbasan do të lidhë kontrata për të rritur mbulimin e shërbimit nga 56.95% në 2021 në 60.79% të popullsisë në zonën e shërbimit deri në fund të vitit 2027. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve do të kontribuojë në rritjen e mbulimit me shërbim në zonat urbane. Vlerësohet se kostoja totale e këtyre investimeve do të jetë rreth 3.6 milionë Lekë.

c. Përmirësimi performancës së shoqërisë

Për të punuar drejt përmirësimit të performances në të gjithë zonën e shërbimit, UK Elbasan do të investojë në blerjen pajisjeve te prodhimit, veglave dhe makinerive duke synuar të përmirësojë performancës e shoqërisë si dhe performancën e shërbimeve të ofruara. Vlerësohet se kjo do të kërkojë një investim që shkon në rreth 50 milionë lekë

17

771
20.06.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3000/1 Prot Elbasan më 23 /06/ 2022

VENDIM
Nr. 74 datë 23 /06/2022

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin MAJ 2022

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 31.01.2022 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **MAJ 2022** gjithsej 231 familje me një fond prej 809.626 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Përgj DPPSSSHKI A.Gashi
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

3 3

720

24.6.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 2859/1 Prot Elbasan më 23 /06/2022

VENDIM
Nr 73 datë 23 /06/2022.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MAJ 2022

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 31.01.2022 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin MAJ 114 familje me fond 292.320 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.përgj pol SSSHKI A.GASHI

Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Ciftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*